

Pyetjet dhe përgjigjet nga Takimi Orientues i zhvilluar më 26 Prill, ora 10:00, si pjesë e thirrjes së dytë për projekt propozime nga projekti ideAL

**1. A mund të ketë një ndërthurje mes aktiviteteve që kanë në synim advokimin me institucionet vendimmarrëse dhe aktivitete të tjera në terren me grupet e interesit?**

Po, patjetër. Këto dy tipologji aktiviteteve mund të jenë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, për aq kohë sa ato i shërbejnë objektivit të përgjithshëm dhe janë në linjë me objektivin e kësaj thirrje. Si pjesë e aktiviteteve që mund të zhvillohen në terren janë proceset e hulumtimi dhe mbledhja e evidencave, vëzhgimet, zhvillimi i pyetësorëve, diskutimet me grupet e ndryshme të interesit dhe çdo aktivitet i parashikuar në seksionin 2.1.2 në dokumentin e thirrjes për projekt propozime.

**2. A përfshihen trajnimet si pjesë e aktiviteteve?**

Në seksionin 2.1.2 të dokumentit të thirrjes për projekt propozime renditen të gjitha aktivitetet të cilat janë të lejueshme për t'u mbështetur financiarisht në kuadër të kësaj thirrje. Pjesë e këtyre aktiviteteve mund të jenë edhe trajnimet, por ato nuk duhet të konsiderohen si aktivitete thelbësore sepse qëllimi i tyre është ngritja e kapaciteteve dhe njohurive, gjë që nuk është në fokus të kësaj thirrje. Nuk duhet harruar dhe fakti që shërbimet e konsulencës apo asistencës të natyrës zhvillimore nuk janë në fokus të kësaj thirrje dhe për pasojë nuk janë aktivitete të lejueshme.

**3. Sa përqind të projektit mund të zënë investimet e një politike të caktuar?**

Kjo thirrje nuk parashikon apo mbështet investime. Sipas nevojës, lejohet blerja e pajisjeve të cilat konsiderohen thelbësore për të ndikuar në të gjithë procesin, por nuk duhet të zënë pjesën më të madhe të buxhetit të projektit tuaj. Përmes kësaj thirrje synohet financimi i projekteve për procese dhe ekspertiza për të ndikuar në ciklin e politikave dhe jo për pajisje e investime për përmirësim infrastrukture ( si p.sh blerje koshash) apo përvetësimin e kompetencave të institucioneve. Të gjitha aktivitetet që financohen dhe kostot e lejuara mund t'i gjeni në dokumentin e thirrjes për projekt propozime. Në rast paqartësie apo dyshimi, jeni të lutur të na kontaktoni përmes adresës [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org).